

Kombetarja/ Stervitje ne Kavaje nen shi

nga AlbaniaSoccer
E martë, 05 Tetor 2010 19:55



Ekipi kombetar ka zhvilluar seancen e radhes ne stadiumin “Besa” te Kavajes. Nen nje shi te imet dhe mot te vrenjtur kjo seance ka zgjatur rreth 60 minuta. Nen urdhrat e trajnerit Dzmeal Mustendanagicc futbollistet e kombetares kane zhvilluar nje seance jo shume intensive. Fillimisht kane bere stretching, me pas ushtrime me top, gjuajtje, nje test brenda ekipit dhe pak vrap ne fund te stervitjes. Ekipi gjate testit ka qene ne forme dhe jane shenuar shume gola. Trajneri u duk i kenaqur, megjithese ka ende dy dite kohe per ta pregatitur ekipin. Ai nuk e ka zgjedhur ende formacionin titullar, por nga sa u pa nuk do te kete aspak ndryshim nga ndeshja e fundit me Luksemburgun.

Andi Kodra